

MASTER I SHKENCAVE NË “ADMINISTRIM BIZNESI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” synon ta pajisë studentin me:

- Përgatitja e specialistëve me njohuri specifike të aftë për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet me të cilat përballen institucionet publike si Ministri apo drejtori brenda tyre, menaxhimi i Bashkive dhe OJF-ve, etj.
- Pajisja e studentëve me njohuri themelore teorike dhe praktike për marrje përgjegjësi lidhur me kryerjen e analizave kritike dhe të aftë të integrojë veprimtari komplekse në kontekstin e punës me synim arritjen performancës strategjike të organizatës.
- Përgatitja e specialistëve dhe në nivel eksperti me kompetencë të spikatur në menaxhimin e projekteve dhe investimeve, vlerësimin të kapaciteteve prodhuese të tyre në perspektivë.
- Aftësimi i studentëve në analizimin e problematikave teknike dhe ekonomiko-financiare të projekteve dhe të cilësisë së burimeve njerëzore të afta të jenë pjesë e grupit menaxhues.
- Përgatitja e studentëve për një karrierë me drejtim më të specializuar në fushat “Biznes-marketing”, me njohuritë specifike mbi mënyrën e funksionimit të tregjeve strategjike.
- Pajisja e studentëve me aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve që nevojiten për kërkim dhe/ose inovacione, me qëllim që të zhvillojë njohuri dhe procedura të reja të të bërit marketing.

REZULTATET E TË NXËNIT

Studentët pas përfundimit të Programit të Studimit do të jenë në gjendje të:

- Të demonstrojë ekspertizë në aftësitë praktike dhe aspektet teorike të aplikuara në fushën e administratës publike.
- Të paraqesë kompetencë të spikatur profesionale në menaxhimin e aktiviteteve të institucioneve publike, OJQ-ve, etj. dhe burimeve njerëzore të këtyre institucioneve.
- Të demonstrojë aftësi profesionale të bazuara në njohuri të thelluara teorike për njohjen, menaxhimin dhe vlerësimin e kapaciteteve prodhuese të projekteve.
- Të njohë hollësisht zbatimin e rregullave, mënyrat e funksionimit dhe analizën e administrimit dhe menaxhimit të projekteve.
- Zgjerimi dhe thellimi i kompetencave në fushat e marketingut dhe shitjeve, analiza strategjike të tregjeve vendase dhe të huaja.
- Të vlerësojë sfidat me të cilat përballen bizneset në treg dhe të jetë në gjendje të zhvillojë strategji të qëndrueshme në mjediset e marketingut duke marrë parasysh teknologjinë e informacionit.

PROFILI: ADMINISTRIM PUBLIK

- Të demonstrojë ekspertizë të bazuar në përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike në fushën e administratës publike, politikëbërjes dhe zbatimit të politikave të qeverisjes në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- Të njohë dhe të zbatojë njohuritë bashkëkohore ndërkombëtare dhe shqiptare, në fushën e menaxhimit dhe administrimit të pronës publike, nëpërmjet funksionimit të organizatave ndërkombëtare, organizatave kombëtare dhe jofitimprurëse.
- Zbatimi dhe përdorimi i koncepteve kryesore në fushën e administratës publike.

PROFILI: MENAXHIM DHE VLERËSIM PROJEKTESH

- Të demonstrojë ekspertizë për shkak të përvetësimit të njohurive të thella teorike dhe praktike në veçanti në fushën e menaxhimit, administrimit dhe vlerësimit të projekteve.
- Të jetë në gjendje të zbatojë njohuritë teorike dhe praktikën bashkëkohore ndërkombëtare në fushën e projektimit, planifikimit, organizimit, menaxhimit, vlerësimit dhe raportimit të projekteve investuese në biznes dhe më gjerë.
- Të identifikojë dhe zbatojë tregues të ndryshëm për vlerësimin e kapaciteteve prodhuese dhe financiare të ndërmarrjeve pavarësisht nga fusha e veprimtarisë

PROFILI: MENAXHIM MARKETINGU

- Të demonstrojë ekspertizë në aspektet teorike dhe veçanërisht në aftësitë praktike të zbatueshme në fushën e tregjeve, standardeve, marketingut, reklamimit dhe promovimit etj.
- Të njohë teorikisht dhe të zbatojë në praktikë reklamën, inovacionin në marketing.
- Të jetë në gjendje të analizojë operacionet në tregje të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare, të njohë psikologjinë e konsumatorëve, të identifikojë dhe plotësojë nevojat e tyre

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve:

1. Administrator i përgjithshëm në organizata publike, private, jo fitim prurëse
2. Analist i proceseve operacionale.
3. Analist tregu
4. Administrator në institucionet e qeverisjes vendore
5. Administrator në sektorin e shërbimeve publike
6. Administrator i përgjithshëm i institucioneve kombëtare ekzekutive
7. Drejtues në sektorin e shërbimeve të administratës publike
8. Drejtues në administratën publike
9. Drejtues në sektorin e kostove dhe çmimeve
10. Drejtues projektesh
11. Ekonomist në sektorin e administratës publike
12. Hartues buxheti në sektorin privat dhe atë publik
13. Hartues dhe vlerësues i plan bizneseve dhe projekteve
14. Menaxher marketingu
15. Menaxher në sektorin bankar



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



16. Menaxher në sektorin e sigurimeve.
17. Menaxher portofoli.
18. Menaxher shitjesh
19. Menaxher i burimeve njerëzore
20. Menaxher projekti
21. Menaxher investimesh
22. Menaxher marketingu
23. Menaxher reklame dhe promovimi
24. Sekretar i Përgjithshëm në Ministri
25. Specialist për Operacionet (Drejtues i Operacioneve)
26. Specialist i shërbimit civil
27. Specialist i treguesve ekonomik (INSTAT)
28. Studiuues dhe përpunues i të dhënave ekonomik – statistikore.

MASTER I SHKENCAVE "ADMINISTRIM BIZNESI" 120 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emertimi i lëndës	ECTS
-----	------	-----	-------------------	------

A - Lëndë bazë 5-10% / 12 ECTS/ 2 lëndë

1	I	1-2	Metoda kërkimi në biznes	12
---	---	-----	--------------------------	----

B - Lëndë karakterizuese 50-60%/60 ECTS

1	I	1	Marketing strategjik	6
2	II	2	Menaxhim Cilësie	6
3	I	2	Komunikimi, etika dhe lidhshipi në organizatë	8
4	II	1	Menaxhim operacionesh dhe sistemesh informacioni	10
5	I	2	Menaxhim financiar	6
6	I	1	Menaxhim strategjik	10
7	I	1	Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	6
8	I	2	Menaxhim inovacioni	8

C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese 12-20% / 18 ECTS

Profili I:		Menaxhim Marketingu		
1	II	2	Marketing shërbimesh	6
2	I	2	Marketing Ndërkombëtar	6
3	II	1	Komunikimi marketing i integruar	6
Profili II:		Administrim Publik		
1	II	1	Menaxhimi i Shërbimeve Publike	6
2	II	2	Prokurim publik	6
3	I	2	Vlerësimi i politikave publike	6
Profili III:		Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh		
1	I	2	Aftesi Manaxheriale	6
2	II	1	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
3	II	2	Vlerësim ekonomik projektsh	6

D- Lëndë plotësuese/ 10% / 12 ECTS

1	II	1-2	Praktikë / internship	12
---	----	-----	-----------------------	----

E - Detyrime përmbyllëse 10-15%/18 ECTS

1	II	1-2	Punimi Diplomës	18
---	----	-----	-----------------	----

Totali 120